



PROCESVERBALI

Mbledhja e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB) në Rahovec, e mbajtur më **08.11.2022** me fillim në ora 15:00. Mbledhjen e kryesoi kryetari komunës **Smajl Latifi**. Kuorum për mbajtjen e mbledhjes kemi. Kryetari - Më lejoni t'i përvendos të gjithë anëtarët e KKSBB-së, përvendos nënkyetarin e komunës, Fatmir Iska, drejtoret e drejtive, komandantin e stacionit të policisë në Rahovecit z. Fazli Morina, oficerin e FSK-së, përfaqësuesit e OSBE-së, përfaqësuesit e LMT-së, përfaqësuesit e bashkësive fetare, përfaqësuesit e mediave dhe gjithë të pranishmit e tjerë. Është mbledhja e gjashtë e rregullt e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi. Për këtë mbledhje propozoj këtë:

Rend Dite

- 1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e komunës së Rahovecit;**
 - Menaxhimi i parkingjeve në qytet dhe ndriçimit publik,
 - Lirimi i trotuareve dhe hapësirave publike,
- 3. Plani i kursimeve të energjisë elektrike dhe përdorimi i përgjegjshëm i lëndëve djegëse;**
- 4. Monitorimi dhe raportimi mbi nivelin e sigurisë në shkolla dhe zbatimin e planit për siguri në shkolla;**
- 5. Të ndryshme;**

Kryetari – Ky është rendi i ditës për sot, nëse dikush ka ndonjë ide për ndonjë propozim shtesë apo largimin e ndonjë pike nga rendi i ditës, urdhëroni fjala është e juaja... Atëherë e hedhim në votim, kush është për?... Votë kundër?... Abstenime?... Faleminderit, konstatojmë miratimin e rendit të ditës.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryetari – A ka dikush komente, vërejtje ose plotësime rreth procesverbalit?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim, kush është për?... A ka votë kundër?... Abstenime?... Konstatojmë që është miratuar procesverbalit i mbledhjes së kaluar.

2. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e komunës së Rahovecit;

Kryetari – E hapim diskutimin dhe mund të konstatojmë që gjendja e sigurisë në komunën tonë është stabile dhe e qetë, përkundër faktit që ka sfida, shkelje të caktuara dhe probleme të ndryshme por të cilat nuk e cënojnë sigurinë në qytetin tonë.

Fazli Morina – Faleminderit kryetar. Përvendosje për të gjithë të pranishmit në sallë. Sa i përket çështjes së sigurisë në komunën tonë nga takimi i fundit para dy muajve, vlerësohet një situatë e qetë dhe stabile pavarësisht problemeve dhe rrëthanave tjera që ndodhin çdo ditë, por që janë të natyrave të lehta. Gjatë periudhës së raportimit për këta dy muaj, në stacionin policor në Rahovec janë të regjistruar gjithsej 88 raste të veprave penale dhe 2 incidente jopenale. Nga këto mund t'i veçojmë disa më me rëndësi; Vjedhje të

rëndomta janë 5, vjedhje të rënda 10 raste, dhunë në familje për fat të keq 11 raste, armëmbajtje pa leje 3 raste, përdorimi i armës apo mjetit të rrrezikshëm 1 rast, pjesëmarrje në turmë që kryhet vepra penale dhe huliganizëm 1 rast, konfiskimi i armëve 3 raste, emetim i armës 1 rast. Kur jemi te rastet që janë brengë e jona dhe e të gjithë qytetarëve të komunës sonë, janë lokalet e natës në fshatin Xërxe. Gjatë kësaj kohe kemi një ngacmim seksual në një lokal nate në Xërxe, lëndim trupor gjithashtu në një lokal në Xërxe, kanosje në lokalet e natës në Xërxe. Këto raste janë indikatorë që në lokalet e natës Xërxe ka raste të shpeshta të cilat paraqesin rrrezik për të gjithë banorët e komunës së Rahovecit në përgjithësi. Është pengesë edhe për tregun, bizneset, shkollat dhe gjithë të tjerët duke marrë parasysh që Xërxa është udhëkryqi kryesor që na lidh me rajonet tjera. Siguria në komunikacioni rrugor vazhdon, jemi në implementim të të gjitha planet operative. Gjatë kësaj periudhe janë të shqiptuar gjithsej 1440 gjoba trafiku, prej tyre në lirimin e hapësirave publike nga automjetet dhe parkingjet ilegale janë gjithsej 222, dhe 10 kundërvajtje të prishjes së rendit dhe qetësisë publike. Siguria në shkolla edhe pse konsiderohet që është e qetë dhe stabile mirëpo nuk ka qenë edhe pa problem; Gjatë kësaj kohe kemi 5 raste të paraqitura nga shkollat. Asgjësim apo dëmtim i pasurisë është në shkollën "Xhelal Hajda - Toni", sulm seksual në "Ukshin Hoti" në Krushë të madhe, mbajtja në pronësi të paautorizuar të armës në "Faik Konica" Celinë dhe kanosje në shkollën e mesme profesionale "Selajdin Mullabazi - Mici". Pak më shqetësues është rasti në Ratkoc, lëndim i lehtë trupor i një nxanëse me çrast janë arrestuar tre femra dhe të trijat kanë shkuar në mbajtje 24h, tjetra e moshës madhore për 48h dhe rasti ka përfunduar në hetime në vazhdim. Kërkesë e jona rrëth kësaj çështje për këtë dy muajt e fundit që drejtoria për inspektim të angazhohet më shumë në lokalet e natës në Xërxe. Ne patrullojmë dhe i vëzhdojmë çdo natë, mirëpo është e pamundur të funksionojmë vet, përkundër që orari është i specifikuar dhe definuar, lokalet vazhdojnë punën deri në orët e mëngjesit. Tjetër; Një kërkesë që po e përsërisim më shpesh, është vendosja e kamerave të sigurisë në varrezat ortodokse këtu në lagjën në kodër dhe vendosja e kamerave tjera në Hoçë të Madhe.

Shaip Shala – Përshëndetje kryetar. I kam dy pyetje për komandantin e nderuar. Komendant, deri ku kanë shkuar hetimet e prokurorit në lidhje me incidentin në palestër në lojën kundër Prizrenit?... Kam qenë i pranishëm në lojë, duke e luajtur rolin e policit në komunitet për t'i qetësuar tifozët dhe Vreshtarët. Jam në dijeni që janë marrë në pyetje rrëth 10 persona por deri ku kanë shkuar hetimet?... Pyetja tjetër; Është shumë shqetësues fakti që dhuna në familje është në rritje (12 raste për dy muaj), por çfarë kanë qenë sanksionet? E di që dikush është dënuar me të holla, dikush me vërejtje, e dikush me kusht 1 vit. A ka pasë deri tanë burgim për ata njerëz që janë dhunues, po i shoh njerëzit recidiv duke shëtitur dhe duke mos u dënuar fare.

Fazli Morina – Kryetari e tha, por po e përsëris edhe unë, mos hezitoni nëse dikush ka diçka konkretisht, çfarë do rasti që i intereson edhe rrjedha e përfundimi dhe të gjitha, shprehuni dhe kërkoni. I nderuar Shaip, faleminderit për angazhimin tënd që po iu del në ndihmë atje tifozëve pavarësisht rrëthanave. Rasti i fundit i përmendor është shumë e vërtet që ka ndodh, ka qenë tollovi e madhe. Fillimisht me urdhër të delegatit është zbrazë salsa, pjesa e dytë ka vazhduar pa tifozë dhe ka shkuar në rregull. Të identifikuar janë 10 persona, janë intervistuar dhe është kompletuar rasti i cili ka vazhduar në prokurorinë themelore në Gjakovë. Kush do të dënohet dhe çka do të ndodh mbetet të shihet, ne jemi të obliguar të hetojmë dhe t'i dërgojmë informatat e këruara. Te rastet e dhunës në familje, është e vërtetë që numri është në rritje. Nuk është ajo që nuk ndalohen, nuk u vazhdohet burgimi ose nuk burgosen, varësisht nga pesha e rastit, nga lëndimet e dhunës fizike, vlerësohet me seancë gjyqësore dhe merret vendim i drejtë për të gjithë.

Kryetari – Faleminderit komandant. Besoj që është shumë e nevojshme që të ndodh lirimi i trotuareve dhe hapësirave publike nga policia e Kosovës në bashkëpunim me inspektorët. Konkluzion tjetër është që inspektorët ta respektojnë vendimin e kryetarit të komunës që përbazë e ka edhe rekondimin e KKSB-së që lokalet e natës të myllen në ora 23:00 dhe nuk do të ketë pardon, duhet të myllen sepse nuk kanë leje operimi pas orës 23:00. Kjo vlen për qytet dhe fshat. Qentë endacak përsëri kanë filluar të bëhen problem si në

qytet poashtu edhe në disa fshatra të mëdha. Natyrisht ne nuk kemi plan konkret për këtë gjë sepse kostoja është shumë e lartë dhe fatkeqësisht edhe nuk kemi plan kombëtar nga shteti. Ndriçimi publik; Mendojmë dhe besojmë që mirëmbajtja e tij e rrit masën e sigurisë në komunë, sikurse vendosja e kamerave të sigurisë sipas kërkeseve specifike që ka policia. Komuna jonë duhet t'i vendos kamerat e sigurisë kudo që ka nevojë dhe jo vetëm në ato dy vende që i përmendi komandanti pavarësish që kostoja e projektit është shumë e lartë dhe jemi në fund të vitit fiskal. Zhurma e motoçikletave pas orës 24:00 është evidente. Kujdestaritë e barnatoreve sipas rregullores së kuvendit të komunës duhet të respektohen dhe ftoj inspektorët që t'i cilësojnë si detyra konkrete edhe kujdestarinë e barnatoreve tona. Mallrat ushqimore dhe eksposzimi i tyre në disa pozicione në qytet dhe në fshatra, është duke vazhduar përkundër faktit që gjobat janë të shumta saqë çështja ka shkuar te përbaruesit. Ndëshkimet do të vazhdojnë çdo ditë, nuk do të ketë tolerance sepse kemi një ligj dhe rregullore që duhet të respektohen. Ne kemi ballafaqime jo të lehta për mbrojtjen e mjedisit, kemi hedhje të mbeturinave vend e pa vend, madje ndotje të mjedisit edhe me mbetje shtazore. Ne kemi shqiptuar gjoba dhe nuk do të kursethet askush sepse tanë kemi një deponi legale, kemi operatorë që i grumbullojnë këto mbeturina dhe i dërgojnë në Landovicë. Si konkluzion themelor për shkak të cenimit të sigurisë sepse mund të ketë kosto edhe me jetë dhe para se të ndodh diçka e tillë, po e ftoj komandantin që t'i ftoj njësitet e veçanta të policisë dhe të veproj nëpër lokacionet ku janë lokalet e natës sepse është vendim i formës së prerë – ligor që ata nuk kanë të drejtë të punojnë dhe të bëjnë veprime të kundërligjshme pas orës 23:00. Parkingjet në qytet janë falas, nuk e di edhe sa do të janë falas sepse ne shpresojmë që do t'i japim në menaxhim. Duke i pasur këto parkingje të shumta e qytetarët vazhdojnë t'i parkojnë veturat nëpër trotuare, kjo nuk do të tolerohet. E ftoj policinë që t'i liroj trotuaret, sepse ka automjete që e bëjnë edhe gjumin nëpër trotuare sidomos nga stacioni i autobusëve e deri tek rrith-rrotullimi që të shpie për Xërxë.

3. Plani i kursimeve të energjisë elektrike dhe përdorimi i përgjegjshëm i lëndëve djegëse;

Kryetari – Sa për ta hapur bisedën po ju tregoj që 85 euro e kemi blerë një metër druri sivjet, me para të taksapaguesve, ndërsa 650 euro e kemi blerë një ton pelet. Vitin e kaluar një metër druri ka qenë 48 euro dhe 220 euro një ton pelet. Vetëm paramendoni sa e madhe është kjo rritje e çmimeve të lëndëve djegëse.

Së pari ne kemi për detyrë ta kursejmë energjinë dhe t'i përdorim në mënyrë të përgjegjshme lëndët djegëse në këtë objekt ku jemi këtu. Kjo vlenë për të gjitha qendrat publike, rrjetit të QMF-ve, AMF-ve dhe qendrës së QKMF-së, shkollat tona si dhe në sektorin privat. Kursimi i energjisë është vendim i qeverisë me masa në fuqi sepse paraprakisht dihet se ka një krizë të thellë të energjisë – prodhim të energjisë e që është bërë krizë globale. Kjo i bie që në zyrën time nuk ka nevojë ta ndezë kondicionerin pas orarit të punës dhe që në ditëve të vikendit në asnjë objekt publik të mos ketë drita të ndezura. Rrjedhimisht një kursim i energjisë elektrike si masë efektive që mund ta zbus gjendjen e dimrit që po vjen. Duhet të shpërndahet fuqishëm ky mesazh që të kemi një përdorim sa më të arsyeshëm të lëndëve djegëse. Ndoshta edhe ta ndalim ndriçimin publik në ato zona ku nuk cënohet siguria edhe nëse e bëjmë këtë analizë.

Lulzim Krasniqi – Përvendetje për të gjithë. Sa i përket kursimit të energjisë elektrike dhe përdorimit të lëndëve djegëse, pajtohem plotësisht me këtë fushatë sensibilizuese, por edhe realisht të jetë publikimi i njoftimeve dhe urdhëresave si qeveri lokale të bëhet sensibilizimi përmes rrjeteve sociale. P.sh në Paris ndalen reklamat e bizneseve për disa orë, pse edhe këtu mos të ndalen, kur ka ndriçim publik. Realisht edhe kamerat funksionojnë në rast sigurie.

4. Monitorimi dhe raportimi mbi nivelin e sigurisë në shkolla dhe zbatimin e planit për siguri në shkolla; Kryetari – Ne i kemi pasë disa incidente le të themi të izoluara në 2 shkolla, në Ratkoc dhe Dejnë. Përplasje dhe rrahje midis nxënësve. E ftoj policinë e Kosovës me kapacitetet që i ka të bëjë patrullim më të shpeshta afér shkollave, e ftoj inspektorin sanitarë, inspektorin e punës, inspektorin e shërbimeve publike t'i vizitojnë mjediset për rrith shkollave, t'i shohin kafeteritë që janë afér shkollave të mesme por edhe afér

shkollave fillore, mos ndoshta kanë alkool, potencialisht drogë dhe këto situata duhet të raportohen në Polici, DKA dhe inspektoriat. Më pas të kemi një pasqyrë të qartë se a është i mjaftueshëm ky angazhim që e bëjmë për siguri në shkolla. Mendoj që të gjitha organet drejtuese të shkollave urgjentisht të mblidhen dhe t'i diskutojnë situatat me të cilat po përballen shkollat tonë në komunën tonë. Është mirë që të trajtohet me seriozitet të lartë dhe me kapacitetet e KKSBS-së siguria në shkolla, pra nuk duhet të ia lëmë vetëm policisë, por ka edhe mekanizma, programe, projekte që na ndihmojnë rrëth kësaj çështjeje. Do t'i ftoj drejtorët e shkollave, organet përgjegjëse të shkollave dhe të bisedoj shumë seriozisht me ta në prezencë të komendantit të policisë.

Lulzim Krasniqi – Sa i përket sigurisë në shkolla, nga raporti i komendantit është mjaftë shqetësuese. Para disa kohe kam kërkuar nga psikologët dhe pedagogët që i patëm angazhuar në shkolla, çka kanë identifikuar ata si problematikë aty që ndikon në rritjen e delikuencës?... Pastaj realisht po dëgjoj prej profesorëve që shkollat janë të pa pajisura me kabinete ku zhvillohet mësimi praktik dhe realisht nivelin e ulët në PISA e kemi si pasojë e mungesës së mësimit praktik. Kështu që marrja e masave në këtë drejtim na shpie deri te rritja e nivelit të sigurisë nëpër shkolla, në mësimnxënie, në mësimdhënie dhe në të gjitha problematikat që ndodhin nëpër shkolla.

Fazli Morina – Faleminderit kryetar. Pajtohem plotësisht me propozimin që e dhe për të ftuar drejtorët e shkollave, gjithashtu edhe këshillin e nxënsave dhe do të ishte i mirëseardhur një takim i tillë. Ne jemi në përpilim të një plani operativ dhe nga java e ardhshme do të ketë zyrtar policor në të gjitha shkollat në komunën e Rahovecit, do të njoftohen të gjithë drejtorët e shkollave, të gjithë kryetarët e këshillit të prindërve për nxënës. Do të parandalohet çdo gjë që ka të bëjë me huliganizmin, sigurinë e shumë gjëra tjera.

Kryetari – Faleminderit komandant. Ne e diskutuam edhe çështjen e sigurisë në shkolla dhe këto sinjale kanë të bëjnë më shumë me rritjen e angazhimeve tonë, ndërmarrjen e masave shtesë për të siguruar që në objektet shkollore të kemi siguri më të lartë. Ju ftoj edhe juve si anëtarë të KKSBS-së që ta ndihmojmë arsimin, policinë, inspektoriatin dhe mbi të gjitha sigurinë e nxënësve rrëth dukurive negative që dëmtojnë seriozisht shëndetin si përdorimi i lëndëve narkotike sidomos te kategoria e të miturve të cilët nuk kanë zotësi juridike.

5. Të ndryshme;

Kryetari – A ka dikush diçka rrëth pikës së fundit?... Atëherë ne si KKSBS do ta mbajmë edhe një mbledhje në muajin dhjetor, mbledhja e shtatë dhe e fundit për këtë vit dhe një nga pikat e rendit të ditës do të jetë; Miratimi i planit vjetor të punës së KKSBS-së. Nëse keni ndonjë ide, projekt ose propozim, ejani të përgatitur në takimin e muajit të ardhshëm. Deri atëherë mirë u takofshim, shëndet.

Mbledhja përfundoj në ora 16:10

Procesmbajtësi

Albion Krasniqi

